



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 03.08.2018

**Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2018
shqyrtoi çështjet si më poshtë :**

1. Mbi miratimin e memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve ERE- ZRrEK- OST sh.a-KOST sha.
2. Në lidhje me fillimin e procedurave për shqyrtimin e propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një metodologji të analizës së kosto-përfitimit në përputhje me nenin 156 (11) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017 ,që përcakton një Udhëzues mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike,me shpjeguesin përkatës.
3. Në lidhje me licensimin e shoqërisë “URADRIN” shpk, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
4. Mbi refuzimin e aplikimit të shoqërisë “MP-Hec” shpk, për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga Hec “Niçë”.
5. Fillimin e procedurës për transferimin e plotë të licencës së shoqërsë “OSOJA ENERGY” sh.p.k., me nr. 408 Seria P18 K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.05.2018, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Seman 1”, me vendodhje, Sheq Marinas Fier me fuqi 2MW, për një afat 20 vjeçar dhe kalimin e saj tek shoqëria “Seman1Solar” shpk.
6. Në lidhje me liçensimin e shoqërisë “ EDIANI “shpk, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Informacion mbi kërkesën e shoqërisë “OSOJA HPP” shpk, për shtyrje të afatit të vendimarrjes së bordit të ERE-s.
8. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi I mundësisë së fundit për muajin korrik 2018.